

PRANUAR MË
ACCEPTED ON 07/12/2023
PRIMLJENO
Nr.No.Br. 02/568

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Nr. 02/_____
Datë: 06.12.2023

PROCESVERBAL

i mbledhjes së -I- (parë) të jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Malishevë

RENDI DITËS

Mbledhja u mbajt me datë: 11.09.2023 dhe filloi në ora: 11:20. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 24 asambleistë, drejtorë komunal Sylë Dukolli, Hafir Rexha, Avdi Morina, Blerim Thaçi, Fatmir Ademaj, përfaqësues nga OSBE-ja Sead Raba dhe zyra për informim. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Malishevës z.Argjend Thaçi.

Argjend Thaçi: Përsëritet për të gjithë dhe mirë se keni ardhur në mbledhjen e parë të jashtëzakonshme të kuvendit komunal. Në sallë jemi 24 asambleistë dhe mund të vazhdojmë seancën. Kush është për këtë rend të ditës?

Me vota unanimit miratohet rendi i ditës.

Ashtu siç u dakorduar në seancën e fundit që kjo pikë e rendit të ditës të debatohet dhe trajtohet në një seancë të veçantë, ashtu dhe ndodhi. Paraprakisht me kërkesë të Mirëbindës ne mbajmë dhe një takim të Komisionit, në të cilin takim nuk ka rrjedhur diçka si risi sa i përket përmbajtjes së draftit, përveç disa njësi të specifikohen dhe ato veq janë ekzistuese siç është kabineti i kryetarit, njësia për menaxhimin e burimeve njerëzore, njësia për operimin, njësia e auditimit të brendshëm, sektori ligjor, sektori për raportim informim dhe bashkëpunim, sektori për integritet evropian, sektori për të drejtat e njeriut dhe barazisë gjinore. Si Komision u dakorduar që këto të hedhen në votim si propozim përgjatë seancës. Hapi debatin. Urdhëro, Alban!

Alban Kastrati: Përshëndetje për të gjithë!

Unë falenderoj Komision që kanë bërë një punë të mirë!

Unë kisha disa propozime që t'i bashkangjiten Statutit, mirëpo Kryesuesi i propozoj.

Po propozoj vetëm dhe një sektor që të shtohet, sektori i komunitetit, sektori për menaxhimin e kontratave dhe hartimin e projekteve. Kjo sigurisht hynë në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit, dmth me pas një zyre të veçantë ku bëhen projektet dhe kontratat.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku: Përshëndetje për të gjithë!

Unë kam qenë pjesë e këti Komisioni dhe të përfshira kanë qenë të gjitha grupet politike dhe ajo çka është ndoshta e veçantë e këti Komisioni është se të gjitha propozimet të cilat kanë rrjedhur nga ky Komision ka pasur dakordim të plotë. Ne jemi munduar që të gjitha ato që i kemi paraqit, në kuadër të këti drafti me qenë në përputhje të plotë në radhë të parë me Ligjet që janë ekzistuese dhe jemi munduar me i paraqit gjitha detyrimet dhe të drejtat që rrjedhin nga ato Ligje. Kemi pasur një dakordim të plotë sa i përket kabinetit apo zyrës së kryetarit, që këto njësi faktikisht janë ekzistuese shumica dermuse dhe operojnë me aktivitetet e tyre, mirëpo ka rrjedhur si kërkesë që këto të futen ose të përshkruhen në Statut, duke pasur parasysh disa plotësime apo ndryshime të emërtimeve të tyre, përjashtimisht zyrës ligjore, gjitha njësit e tjera janë aktive dhe i kryejnë ato detyra dhe përgjegjësit e veta që i kanë.

Sa i përket kërkesës që e ngriti Albani, ne e kemi paraparë si Komision që numri i drejtorive të rritet prej dy, nga 11 ekzistuese të rritet në 13. Ajo që ne e kemi parë të arsyeshme dhe si domosdoshmëri e kohës dhe zhvillimit duke e parë pozitën gjeografike që e kemi, ne kemi kërku që Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Buxhet të ndahet, sektori i ekonomis të jetë i veçantë duke e shtu edhe turizmin dmth Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm, kjo ka qenë njëra prej kërkesave nga të gjitha grupet të cilat kanë qenë të përfaqësuara në këtë Komision. Kërkesë tjetër ka qenë që të ndahet Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ku këto të dya do të jenë sektore të veqanta për shkak të natyrës së punës.

Njëra nga propozimet që është e pasqyrune në këtë dokument është edhe kërkesa që e kërkoj dhe Albani, ku kemi kërkuar dhe ne që Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim të mbetet, dhe si sektor i veçantë të jetë Drejtoria për Infrastrukturë, që do të merret me menaxhimin e kontratave që janë përbërse për infrastrukturë, sepse jo të gjitha kontrat mundet me i menaxhu një drejtori e veçantë.

Ajo çka po kërkoj është që të gjithë ta votojm Statutin e Komunës ashtu siç e kemi paraqit dhe jemi munduar me bërë punën më të mirë të mundshme. E kemi parë që nuk është mirë i strukturun, mirëpo Kryesuesi na ka dhënë arsyeshmërinë që në momentin që të votohet në Kuvend, atëherë do të bëhet dhe lektjrimi, strukturimi dhe botimi. Unë po kërkoj tash që secili prej deputetëve me pas nga një kopje të Statutit.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Mirëlinda!

Mirëllinda Gashi: Përshëndetje për të gjithë!

Unë kam qenë pjesë e Komisionit, e përgëzoj Valonin që i përfshini të gjitha ato meritat që i kemi si Komision. Është bërë një punë e mirë dhe gjitha propozimet që janë dalur nga subjektet politike, ato të cilat na ka mundësuar Ligji t'i ndryshojmë, ne kemi bërë ndryshim. Besoj që grupi im është dakord që sot ky Statut i Komunës ta merr dritën e gjelbërt dhe të ecë përpara. Kemi vetëm disa vërejte që në email ka ardhur me gabime gjuhësore, ku disa herë po e humb atë dmt h e fjalisë, ndoshta është dashur të na vijë i lekturum. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Urdhëro, Arlind!

Arlind Morina: Përshëndetje për të gjithë!

Sa i për këtë Statutit të Komunës, unë mendoj që të gjitha grupet kanë bërë punën më të mirë të mundshme në atë Komision dhe ne si grup jemi dakord që të ecim përpara që ky Statut të votohet dhe ta merr dritën jeshile.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Agnesë!

Agnesë Kastrati: Përshëndetje për të gjithë!

Dua ta falenderoj Komisionin për punën që e kanë bërë dhe ne si grup i Vetëvendosjes kemi pasur propozimet tona të cilat me shumicë dërmuese janë miratu dhe për këtë e vlersoj jashtëzakonisht punën e Komisionit dhe bashkëpunimin që e kanë pas. Konsideroj që qështja më e rëndësishme e këtij Statuti është rritja e numrit të drejtorive dhe mua nuk më bindi Valoni me arsyen që e tha se pse duhet me u rrit numri nga 11 në 13, prandaj kisha dashur një arsyetim më të detajuar se qka nuk ka funksionu deri tash me këtë format të drejtorive që po duhet me rrit numrin e drejtorive, përndryshe unë jam skeptike nëse mundem me votu pa një arsyetim më të detajum. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku: Ne aty kemi përfaqësuar interesat politike të këtyre partive politike që jemi në këtë Kuvend. Nuk do të thotë se në qoftëse ne e ndajm një drejtori nuk ka funksionu diqka aty. Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Buxhet është një gam e gjanë e aktiviteteve që kryhen në kuadër të kësaj drejtorie dhe si rezultat i kësaj ne jemi munduar me i ndar përgjegjësitë te aspekti ekonomik duke e shtuar dhe pjesën e turizmit . Turizmi ekziston në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, mirëpo qëllimi ka qenë që kjo të jetë drejtori e veçantë zhvillimi ekonomik dhe turizmi duke marrur parasysh se shumë fonde jepen nga organizata të ndryshme qoftë vendore dhe ndërkombëtare që janë në mbështetje të turizmit. Në komunën tonë janë disa pika që kanë nevojë për investime dhe për trajtim të veçantë për me ardhur deri te rritja e turizmit në komunën e Malishevës.

Sa i përket pjesës tjetër që është mirqenia sociale te hiqet nga drejtoria e shëndetësisë, pothuajse të gjitha komunat në nivel Republike e kanë të ndarë këtë drejtori, për faktin se qendra për punë sociale ka një natyrë pak më ndryshe se sa shëndetësia.

Sa përket pjesës së infrastukturës, ky nuk ka qenë propozim individual, por ka qenë propozim i

të gjithëve dhe ne kemi marrur dhe modele prej komunave të tjera se si ato janë të organizume dhe ne e kemi konsideru që është e domosdoshme me nda këtë pjesën e planifikimit dhe pjesën e menaxhimit, po flas në kontekstin e infrastrukturës në raport me urbanizmin. Një nga drejtorit që kemi kërkuar me u fuzinu ka qenë Drjetoria për Mrojtje dhe Shpëtim që të fuzionohet në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Përshëndetje për të gjithë!

Ne jemi mbledhur për një qështje mjaft të rëndësishme në një seancë të jashtëzakonshme, e që ka të bëjë me miratimin e një prej dokumenteve më të rëndësishme që mundëson funksionimin e administratës së komunës. Statuti i deritanishëm ekziston që nga themelimi i komunës tonë dhe për kohën i ka plotësuar të gjitha ato nevojat për funksionimin dhe administrimin e duhur të komunës, mirëpo gjatë ecjes me kohë ndër vite sigurisht që dalin nevoja dhe qështje të tjera të cilat e kanë pa si domosdoshmëri ndryshimin e këtij dokumenti. Unë e falenderoj secilin prej anëtarëve të këtij Komisioni për punën që e ka bërë.

Ne si grup i NISMA Socialdemokrate kemi qenë gjatë gjithë kohës kur është hartu ky dokument në kordinim me anëtarin tonë në këtë komision dhe të gjitha vërejtjet, rekomandimet tona i kemi dhënë gjatë kohës kur është hartu ky dokument, kështu që ne sot nuk kemi asnjë dokument, asnjë kërkesë përmbajtësore, asnjë amandament përmbajtësor në lidhje me këtë lloj dokumenti.

U përmend këtu që duhet të bëhen disa strukturime e disa lekturime e unë kërkoj që të bëhet një lloj lekturimi tre dimensional, të aspekti i gabimeve teknike, të aspekti i ndonjë gabimi gramatikor- gjuhësor, por më e rëndësishmja është me pas kujdes të formulimi i fjalisë, mos me lënë fjali të paqarta, mos me lënë fjali të dy kuptimta ose të shumë kuptimta, me pas shumë kujdes të emërtimi i fshatrave dhe bashkësive lokale, ashtu siq janë të shkruara zyrtarisht në dokumentet në letërnjoftimet tona, në mënyrë që mos të shkaktohet probleme juridike. Këto gjëra duhet të rregullohen. Do ishte mirë që kjo me ardhë e rregullone në mënyrë që ne ta shohim saktësisht se si është formuluar një fjali, mirëpo meqë nuk është bërë deri tani kjo nuk është problematik për me e rregullu. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Urdhëro, Eqrem!

Eqrem Morina: Përshëndetje për të gjithë!

Unë e falenderoj Komisionin sepse me të vërtetë e ka bërë një punë të mirë, mirëpo e kam një rekomandim. Në emër të Komitetit për vlerat e luftës japi këtë rekomandim: me datën 26.04.1998 në magjistralen Prishtinë-Pejë, tek pishat e Gjurgjices është bërë sulmi i parë frontal i UÇK-së ndaj forcave serbe, dmth në Komunën e Malishevës. Tek neni 11 ditët përkujtimore në Malishevë, mendoj që duhet të futet dhe kjo datë si datë historike.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Alban!

Alban Kastrati: Tek neni 10 të ndarja e çmimeve, çmimi “Imer Krasniqi” për trimëri dhe heroizëm dhe çmimi “Hamdi Berisha” për kontributin dhënë arsimit, ne e kemi diskutuar dhe

kam qenë anëtar i këshillit për organizimin e 16 qeshorit dhe kemi kërkuar që të rritet numri i çmimeve, sidomos në këto dy kategori për trimëri dhe heroizëm, dhe për kontribut dhënë arsimit. Ne i kemi ndar nga dy çmime, unë kam kërku dhe po kërkoj prapë që të rritet numri nga 2 të bëhet në 4, përshak që është një numër i madh dhe i veteranëve që na vdesin të Ushtrisë Çlirimtare dhe veteranëve të arsimit. Ne tani në shumicën e rasteve kemi fillu me nda çmime posmortum dhe do ishte shumë më e mirë, më e ndershme dhe më etike që tu jepen këto çmime sa janë për së gjalli. Muharremi, na shpjegon se a ka këtë të drejt kryetari me nxjerr vendim dhe me caktu çmimin, apo duhet ne sot me dhënë këtë.

Tek pika numër 31, te mandate i anëtarëve të Kuvendit, pika c thotë: nëse anëtar i ja paraqet kryetarit të komunës dorheqjen me shkrim nga posti i tij. Pse kryetarit me ja ofru dorheqjen? Dorheqja ju ofrohet kryesuesit, këtu kërkoj një përmirsim.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku: Sa i përket propozimit të Eqremi, Statuti si draft ka qenë i publikum dhe në faqen e komunës, është mbajtur dhe dëgjimi publik, nuk e di nëse ka pas ose ka mundur kjo me u pasqyru ose mu adresu në kuadër të kësaj periudhë kohore diku rreth 14 dite ka qenë i publikum dhe këtu në kuvend është mbajtur një takim.

Sa i përket pjesës tjetër që e tha Albani tek çmimet, në Statut nuk janë të definu aspekti sasior i çmimeve. A do të shpërndahen dy çmime për trimëri dhe heroizëm” Imer Krasniqi”, apo do të shpërndahen 1 apo më tepër se sa i kemi shpërnda deri tani, kjo bëhet me vendim të veçantë të Kuvendit. Nëse aty është e përshkrume si çmim që do të jetë ky çmim për trimëri dhe heroizëm, ndërsa pjesa se sa ka me qenë numri i përfituesve të këti çmimi, ne nuk është që nuk e kemi menduar si komision, mirëpo e kemi lënë në diskrecion të kuvendit që të vendos a do të jeni 2 apo më shumë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, nënkryetar!

Vesel Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë!

Sot po e diskutojm një akt normativ, i cili është akti më i lartë në nivel komunal për plotësim ndryshim të Statutit të Komunës së Malishevës. Dua ta falenderoj Komisionin të cilët e kanë bërë një punë jashtëzakonisht të mirë, duke u konsultuar pastaj dhe me akter tjerë me subjektet sepse kanë qenë të përfshirë të gjitha grupet parlamentare, në konsultim dhe me profesionalistë ne jemi munduar ta nxjerrim më të mirën e mundshme duke u bazuar në ligje në fuqi, Kushtetutën por edhe komunat tjera se si kanë vepru. Kemi ardhur në një përfundim kemi nxjerrur një akt, me të gjitha ato plotësim ndryshimet dhe dua t'i falenderoj të gjithë për kontributin e dhënë. Po i japi disa sqarime që u ngritën këtu. Numri i drejtorive është rritur, sepse është parë si nevojë ndryshimi i kësaj. Janë përshkruar disa drejtori duke i pasur ligjjet në fuqi dhe nevojat që i ka Komuna e Malishevës. Te zhvillimi ekonomik dhe turizmi, që fatkeqësisht komuna jonë mirë që 1 ka këto bukuri shumë të pasur, mirëpo asnjë zyrtar nuk e kemi për turizëm. Ne kemi menduar si qdo komunë tjetër që e ka zhvillimin ekonomik dhe lehtësim për drejtorin për buxhet dhe financa të lirohet nga disa dikastere kemi parë të rrugës që të bëhet drejtori e veçantë.

Tek shërbimet publike dhe emergjenca, sa për informimin e juaj emergjencat përveq pagave që ju japim zjarrfiksëve ne nuk kemi asnjë kompetencë tjetër dhe duke e parë që kjo drejtori nuk është shumë e ngarkuar me përgjegjësi andaj të funksionohet në drejtorin për shëbrime publike. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenieve Sociale shumë komuna i kanë të ndara dhe ne i shohim që këto dikastiere kanë shumë pak të përbashkëta dhe mirëqenia sociale do një trajtim më të madh, sepse shumë prej linjave dikastierëve apo njësisë të saj lidhen dhe drejtëpërdrejt me ministrien e punës dhe mirëqenies sociale. Duke i parë këto nevojë ne kemi kërkuar që kjo drejtori të ndahet mirëpo nuk do të thotë që në të ardhmen prapë mos të funksionohet, sepse e kemi lënë në diskrecion kryetarit që të bëhen dhe në funksion.

Te Urbanizmi ajo ka lindur si nevojë ligjore, ne kemi hapur procedura në pamundësi ose pa të drejtë, sepse nuk ka të drejtë e njejta drejtori të hartoj projekte, të bëjë pamasa dhe enjejta ti mbikqyrë ato. Shumë prej komunave kanë kontraktuar operatorët ekonomik që të bëjë hartimin e projekteve. Ne kemi kërkuar që të ndahet planifikimi me mbikqyrjen.

Te numri i çmimeve ne i kemi përmendur cilat çmime, ndërsa te numri është e drejtë e asambles komunale të vendos dhe për shumën dhe për numrin e çmimeve.

Eqrem ne e kemi diskutuar dhe këtu në asamble, është vlerë dalja e parë e UÇK, mirëpo qdo herë kemi nga një dalje të parë dhe për mos me u bërë shumë zhurum ne nuk kemi vendosur, kemi në Astrauzp, Temeqinë, Tërpezë, janë shumë pika dalja parë e UÇK-së.

Në të ardhmen mund të ketë ndryshime ligjore përsëri, e që ekzekutivi bashkë me legjislativin kanë obligim qdo ndryshim ligjor kurdo që ndodh ai ta thirr ta formon një komision për plotësim ndryshimit të Statutit dhe të bëhet plotësimi dhe në Statut duke ju përshtat ligjeve. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Urdhëro, Amrush!

Amrush Helshani: Përshëndetje për të gjithë!

Së pari dua ti përgëzoj anëtarët e Komisionit për punën dhe kontributin që e kanë dhënë për hartimin e Statutit të Komunës, i cili është akti më i lartë juridik i Komunës. U përmenden shumë qështje, mirëpo është mirë ndoshta me dhënë një sqarim Komisioni tek neni 31, ku thotë anëtarëri i kuvendit të komunës pushon të jetë anëtarë, pika b nëse ai e ndërron vendbanimin ku ai është zgjedhur. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Urdhëro, drejtor Fatmir Ademaj!

Fatmir Ademaj: Përshëndetje për të gjithë!

Unë kam dy përgjigje dhe për Albanin dhe për Amrushin. Qështja e këtyre dy pikave është e rregulluar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, konkretisht Ligjin 03L/040 neni 37 saktësisht e specifikon mandatet e asambleistëve, deputetëve. Neni 37.2 e specifikon dhe kur e ndërron vendbanimin asambleisti dhe pika tjetër është kur i ofron dorheqjen kryetarit të komunës, kjo është e rregulluar me Ligj. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku: Po nderlidhem te kjo pika dorheqja e asambleistit, ku Ligji siç e thotë me i'a ofru kryetarit dorheqjen. Kemi shumë shembuj që për disa periudha kuvendet komunale skan pas kryesues për shkak të ndryshimeve, ose pa u zgjedhur kryesues ne e kemi pasur rastin këtu që asambleistë kanë dhënë dorheqje dhe si instancë për me i'a ofru këtë e kanë përcaktu kryetarin.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Labinot!

Labinot Gashi: Përshëndetje për të gjithë!

Falenderoj Komisionin për punën, dhe unë kam qenë anëtarë i Komisionit mirëpo me disa mungesa per arsye personale.

Përveq atyre që e thanë parafolesit që ky Statut ka nevojë me u lekturu, unë sa kam mundur me analizu dhe kam qenë pjesë e komisionit, kryesisht për ata që kanë qenë më herët pjesë e kuvendit nenin më problematik ne që e kemi pasur ka qenë neni 10 dhe po me duket që nuk është i formuluar prapë drejtë. Festat publike të komunës së Malishevës ku pika dy thotë shënimin e kësaj dite e organizon Kuvendi i Komunës së Malishevës, ndërsa pika 4 thotë me propozim të kryetarit të Komunës ndahen këto çmime. Mua po më duket që nuk është në rregull, sepse ne në praktikë kemi pasur problem. Unë tek ky nen kam pasur si propozim me pas kujdes, ose është dashur me e cek që Kuvendi i Komunës me vendim të veçantë formon Komision për organizimin e kësaj dite dhe pranon propozime për këto çmime. Mos me ju molu e drejta, sepse ka të drejt dhe një qytetar me sjellë një propozim për këto çmime, që mundet me qenë më i qëllim se sa këto shoqatat që po i sjellin.

Te rritja e drejtorive, qdo rritje e drejtorive nënkupton rritje të kostos buxhetor, mirëpo një sektor që ne si komunë kemi çka me dhënë që është lënë pas dore, kisha propozu që me fuzjonu në kuadër të drejtorisë së kulturës trashëgimin kulturore, ne kemi projekte të buxhetume e të votume me dekada, të cilat kurr nuk kanë gjetur zbatim. Këto ishin vërejtjet e mia.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Mirëlinda!

Mirëlinda Gashi: Unë deshat të shtoj diqka te Drejtori Fatmiri, ne në Komision e kemi pasur një debat dhe desha ti them drejtorit që më shumë rekomandime dulen prej grupeve të juaja, sesa nga grupi im.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Agnesë!

Agnesë Kastrati: Pavarsisht dakordimit që e keni pasur në shumicën e pikave në Komision, përderisa e keni thirrur një mbledhje të veçantë, ku e trajtojm veqmas këtë pikë të renidit të ditës dhe përderisa i thojmë ende draft, konsideroj që vërejtjet, sugjerimet janë për të gjithë anëtarët e kuvendit komunal dhe do duhet të jenë të mirëseardhura. Nëpërmjet anëtarit tonë ne jemi dakorduar për shumicën e qështjeve në Komision, ne kemi pasur dhe takime me Vetonin dhe ai i ka përcjellur vërejtjet tona me kohë në komision, sa i përket nenit ku ndërlidhet me rritjen e drejtorive. Pozicioni i jonë është i njëjtë sikurse pozicioni i Vetonit që e ka paraqit më herët. Për qështjet tjera ne dakordohemi plotësisht, ndërsa për qështjen e rritjeve të numrit të drejtorive nuk ka pasur pajtueshmëri të plotë në Komision.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Labionoti e ngriti një qështje që është me rëndësi. Statuti i vjetër e ka pasur një lloj paqartësie të emërimit të institucionit të komunës. Komunës tonë ju ka referu Kuvendi Komunal i Malishevës, pra kur është përmendur termi Kuvendi Komunal i Malishevës nuk ka nënkuptu Kuvendi këtu, mirëpo institucioni në tërësi si komunë. Nëse dikun është përsëritur ky emërtim i institucionit të komunës me emrin Kuvendi komunal Malisheve këtë duhet me heq dhe me bërë Komuna e Malishevës. Emrin zyrtar ky institucion e ka Komuna e Malishevës.

Institucionet kryesore janë Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës.

Te qështja që e ngrit Labinoti ka mundur me qenë ky paqartësim, çmimet i ndan Kuvendi Komunal i Malishevës nënkupton për komunën sepse ne e krijojmë një komision i cili është prej Kuvendi dhe prej zyrës së Kryetarit. E rëndësishme është që mos me u ngatërru këto koncepte Kuvendi Komunal dhe Komuna e Malishevës.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Alban!

Alban Kastrati: Unë pajtohem plotësisht me këtë që e tha Halili, është e vërtetë ajo që e bërë dallimin e kësaj. Desha të ndërlihem te propozimi i Labinotit që drejtorisë së kulturës ti shtohet dhe termi trashëgëmi. Unë ku punoj në Ministrinë e Kulturës, punoj në institutin për mbrojtje të monamenteve dhe ne kemi 7 qendra rajonale të trashigimisë kulturore që operojnë në gjithë territorin e Kosovës. Qendra rajonale në Prizren e mbulon dhe pjesën e Malishevës, Rahovecit, Suharekës diku 6 komuna dhe është një dikastier mjaftë i rëndësishëm sepse kemi asete të trashigimisë që kanë vlera shumë të mëdha. Unë e përkrahi këtë propozim të Labinotit që ti shtohet dhe një term trashëgimi, ta kemi dhe ne një zyrtar që merret vetëm me asetet e trashëgimisë kulturore.

Argjend Thaçi: Urdhëro, drejtor Fatmir Ademaj!

Fatmir Ademaj: Është qështja e procedurave, përshkak se nëse fillojmë të thuhet Drejtoria e Administratës, e gjendjes civile dhe shërbimit ndaj qytetarëve, po dua të ndërlihem në mënyrë direkte, po në secilën drejtori i imbligohet nga një diqka që drejtoria i shërben por nuk mundet me lënë në titull të drejtorisë. Drejtoria për Kulturë e ka zyrtarin ose programin e saj, e ka pjesën e trashigimisë. Në aspektin tjetër që e ngriti Labinoti plotësisht ka të drejtë, se institucionet janë dy, organi më i lartë është Kuvendi pastaj Kryetari dhe rrjedhimish dhe këtu është paraqitur se propozimin e bënë kryetari nga komisioni të cilin e delegon kuvendi, patjetër që me konsensus ose me vota të komisionit dhe kryetari i propozon kuvendit dhe pastaj kuvendi vendos.

Veseli Krasniqi: Unë mendoj që është e përshkrume mirë, mirëpo shpeshherë ndoshta gjatë ekzekutimit mundemi me i komplikuar dhe me i përzi kompetencat. Propozimi vjen prej kryetarit ndarja e çmimit për me hyrë në rend të ditës në Komitet pastaj në asamble, mirëpo shpeshherë ka ardhur dhe drejtpërdrejtë. Kryetari i bjen në rend të ditës e bënë propozimin është e drejtë e kryetarit që don me ndarë qmime se i parashihet Statuti, hynë në rend të ditës, pastaj është në diskrecionin e juaj, e formoni komisionin keni me i caktuar sa qmime të veteranëve sa të shëndetësisë dhe sa të arsimit dhe sa do të jetë vlera e çmimit e pastaj propozimi i komisionit

vjen dhe votohet.

Trashëgimia ekziston është njëësi në kuadër të Drejtorisë së Kulturës. Ne mundemi me zgjat me marr nga njësia me vendos në titull të drejtorisë, mirëpo mendoj që ajo funksionon nuk shohë ndonjë mungesë të kësaj. Diaspora nuk ka qenë, e kemi futur me propozim të Mirëlindës.

Argjend Thaçi: I kemi disa propozime, së pari po e hedhi në votim që këto njësi të jenë pjesë e Statutit: kabineti i kryetarit, njësia për menaxhimin e burimeve njerëzore, njësia e prokurimit, njësia e auditimit të brendshëm, sektori ligjor, sektori për komunitete dhe kthim, sektori për raportim, informim dhe bashkëpunim, sektori për integritet evropian dhe sektori për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore. Urdhëro, nënkryetar!

Vesel Krasniqi: Vetëm një sqarim desha ta jap, te kabineti i kryetarit hyjnë ato tjerat.

Argjend Thaçi: Kush është për që këto njësi të hyjnë si njësi të veqanta në Statut?

Me vota unanime, këto njësi futen në

Statut.

Propozimi tjetër ishte nga Eqremi që data: 26.04.1998 që të hyjë në kuadër të datave historike.

Urdhëro, Mirëlinda!

Mirëlinda Gashi: Ishin disa propozime, miëpo po flas si anëtare e komisionit meqë i kishim disa përgjigje nga nënkryetari është mirë që dikund ndokush me u tërhek dhe në qoftëse jo ne shkojmë me votë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Eqrem!

Eqrem Morina: Unë tërhiqem nga ai propozim.

Argjend Thaçi: E hedhi në votim Statutin me ndryshimin që e kishim. Kush është për?

Për: 24

Kundër: 0

Abstenim: 1

Me 24 vota për, asnjë kundër dhe 1 abstenim miratohet Statuti i Komunës së Malishevës.

Këtë mbledhje e shpalli të mbyllur.

Përfundoi në ora: 12:17.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina

